MOT' I PARƐ VJEϬT' E III ðe ϬƐNƐNDRE 1909 № 11 ðe 12

# DITURIJA

## E PƐRKOHƐϬME ϬϘIP LITERARE ƂE DITURAKE

**DEL NƐ HERƐ NƐ MUAJ**

*Dreqtoɥεs:* LUMO SKƐNDO

MBAN:

Tε mεsojmε guhεnε: Lumo Skεndo. — Tε dimε tε siλemi: — Fjalε tε urta. Atje tej (vjerϭε): Rras' e Barðε. — Buk' e maλεkuarε (vjerϭε): Lulo Malεsori. — Lija nε Izmir (vjerϭε): Mahmud Pεrmeti. — Trεndafili ðe vâri (vjerϭε): L. M. — Ç' janε yjtε me biϭt ðe yjtε qε kεputenε? — Karta. — Bibliografi.



SELANIK

# DITURIJA

---

## Tε mεsojmε guhεnε.

Si doλi nga harimi ku iϭ heꝺurε guha jonε ꝺe si ϭpεtoj nga ndalim i triꝺet vjetve ku iϭ liꝺurε, me gaz tε maꝺ po ϭohim se qε dy vjet e tεhu mεsim' i ϭqipese mori ηε hov tε ri ꝺe — sikur pεr tε arritur atε kohε qε kemi humburε — ηε zel i maꝺ εϭtε dukurε nε kεtε mεsim

Po ηeriu durimin e ka tε pakε, a me fjalε tε tjera, Ϭqipεtarεt dεϭirεn' e kanε mê tε maꝺe se sa durimin. Me tε zεnε qε tε mεsojmε guhεn t' εnε, ϭumε pej neϭ deϭmε qε tε bεhemi me ηε dit tε diturε ꝺe tε zotεrit e asaj guhe, kur pεr tε mεsuarε mirε guhεt e tjera nxεnεsit janε tε ϭtrεnguarε tε pεrpiqεnε kaqε kohε nεpεr ϭkoλatε: ηε tyrk, ηε grek, ηε francεs, ϭkurtazi çdo komb, ka nevojε qε tε vejε ꝺe tε nxεrε disa vjet nε ϭkoλε guhεn e tij pa mezí tε ꝺotε se e mεsoj me tε vεrtet.

Po ne kemi ꝺe ηε tε veϭtirε tjatrε pεr tε mεsuarε guhεnε: veç qε s' kemi vajturε nε ϭkoλε, po eꝺe vegεlat qε kemi na janε tε meta: na mungojnε librat' e kεndimit ꝺe s' kemi nε dorε no ηε fjalεtore tε mirε qε tá pεrdorim pεr tε begatuarε ꝺe tε zgεruarε diturinε t' εnε.

Nga kεta ϭkake pra e dimε qε do tε heqim ca mundime, po kjo s' duhetε qε tε na dobεtojε ꝺe tε na pakεsojε kurajon ꝺe deϭirεn t' εnε.

Kεndoηεset tε daϭurε tε mij u kεϭiλoj herεn' e parε qε nε daçin tε mεsojnε mirε ϭqipenε, tε kendojnε me kujdes tε maꝺ giꝺε sa libra ϭqip qε janε ϭkruarε ꝺe tε ϭεnojnε fjalεt e ra qε gejnε duke u-pεrpjekurε qε t' u kupεtojnε mirε dεftesat e tyre, ꝺe tε bεjnε ηε defter tε vogεlε si fjalεtore. Tá dini mirε qε duke mbleꝺurε keϭtú fjalε do tε ϭohim se guha jonε s' εϭtε ꝺe aq' e varfεrε sa na dukεtε; do tε ϭohim qε ꝺe çpikj' e fjalεvet tε ra εϭtε fort lehtε pεr ϭqipenε, ꝺe kεta studime do tε na bεjnε ꝺe ne qε t' i ϭohim hoλεsit' e guhεsε ꝺe begatin' e saj. Kεtó fjalε pa dyϭim duanε ϭtuarε me ató qε dεgojm' me veϭ tanε, se ϭumε herε nε kuvεnt e siprε ηeriu mεson ηε tok fjalε qε as i pandehte fare. Εϭtε mirε qε kεtyre fjalεvet tε ra t' u ϭεnohetε vendi ku janε par' a dεguarε.